

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – koleji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridiket paditëses V. G. K. nga Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar I. K., avokat nga Rahoveci, kundër të paditurit K. S. H., nga Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Q. Q., avokat nga Rahoveci, për shkak të vërtetimit të atësisë, përkritazi me revizionin e të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 3801/2015 datë 29.3.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10.10.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 3801/2015 datë 29.3.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 3801/2015 datë 29.3.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr. 73/2014 datë 29.6.2015, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe është vërtetuar se i ati i fëmijës së mitur A. K., është K.S. H. nga komuna e Rahovecit. Me pjesën II të dispozitivit është urdhëruar zyra e gjendjes civile në Ratkoc që të paditurin K. S. H., ta regjistroj si prind natyror i fëmijës së mitur A. K. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar i padituri që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet procedurale në shumë prej 1.381 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i padituri me kohë ka paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja V. K., më datë ... ka lind fëmijën A. K., I padituri ka mohuar se është i ati i fëmijës së lindur, për të cilën arsye paditësja ka kërkuar që përmes analizës së gjakut dhe ADN-së të vërtetohet atësia e prindërit. Paditësja ka propozuar që analiza e cekur të bëhet në Tiranë, laborator N., ndërsa i padituri në përgjigjen në padi ka propozuar që analiza e ADN-së të bëhet pranë Entit për Mjekësi Ligjore dhe Kriminalistikë, në Shkup-Maqedoni.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës ka pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për një gjykim të drejtë e të bazuar në ligj, të cilat arsye i mbështet edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Thëniet e revizionit se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të zbatimit të gabuar të dispozitës së neni 113 të Ligjit për Familjen të Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka arsyetuar bazën ligjore të marrjes së aktgjykimit duke zbatuar nenin 103.2, 110 par. 1 e 4 të Ligjit mbi Familjen të Kosovës.

Pretendimet e cekura në revizion se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar që palët ndërgjyqëse janë burrë e grua dhe se ata ishin në martesë, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi, por të njëjtat nuk ndikuan që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe, ngase as me padi e as me precizimin e padisë nuk është kërkuar statusi i palëve ndërgjyqësve, andaj gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar nenin 2 të LPK, duke vendosur brenda kufijve të kërkesëpadisë.

Faktin e cekur se i padituri nuk ka pasur kontakte intime me paditësen dhe kërkesën për një ekspertizë tjetër të ADN-së, në ndonjë shtet tjetër të Evropës, kanë qenë pretendime edhe sipas ankesës pranë gjykatës së shkallës së dytë, për të cilat pretendime janë dhënë arsye të mjaftueshme e të bazuara në provat konkrete, të cilat i mbështet edhe kjo Gjykatë. Me të drejtë gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se propozimi i të paditurit për ekzaminimin e ADN-së në ndonjë institut tjetër më kredibil në Evropë nuk qëndron, pasi që ekzaminimi i ADN-së është kryer nga Fakulteti i Mjekësisë-Universiteti “Shën Kiril dhe Metodj”, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Kriminalistikë dhe Deontologji Mjekësore në Shkup, sipas kërkesës së vetë palës së paditur, nga i cili raport ka rrjedh konstatimi se i padituri K. H., në bazë të probabilitetit të fituar bio statistik me 99,9999%, është baba biologjik i fëmijës.

Thëniet tjera të paditurit të cekura në revizion se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, kjo Gjykatë e revizionit nuk e shqyrtoi, ngase në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.231/2016, më 10.10.2016

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku